

“Namazi e largon
njeriun nga shthurja
dhe nga të gjitha
veprat e shëmtuara.”
(Sureja Ankebut, Ajeti 45)



Kijam (Qëndrimi në këmbë)

Farzi i dytë i namazit është kijam, pra qëndrimi në këmbë. Pas Tekbirit fillestar i lidhim duart siç tregohet në figurë dhe lexojmë, Subhaneken, Fatihanë dhe disa ajete nga Kur’ani Kerim. Këndimi i këtyre është farzi i tretë i namazit. Kjo quhet “**Kiraat**” (Këndimi i Kur’anit të madhërueshëm me zë).

Fëmijë!
Mësimi përmendësh i
sureve të shkurtëra në
fund të Kur’anit Kerim,
është më e lehtë.

Namazi është një adhurim tepër serioz. Nuk duhet të harrojmë që gjatë namazit jemi në prani të All-llahut dhe nuk duhet të mendojmë asgjë tjetër përveç ajeteve që këndojmë.